



Ku të aplikoni?

Në Agjencinë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës (EACEA).

Kur të aplikoni?

Aplikantët duhet të dorëzojnë aplikacionin e tyre për grant brenda afatit të shpallur brenda thirrjes së vazhdueshme për propozime Erasmus+.

Kritere të tjera

Nga i njëjtë aplikant mund të dorëzohet vetëm një propozim për çdo afat. Nëse më shumë se një propozim dorëzohet nga i njëjtë aplikant, vetëm aplikimi i parë do të merret parasysh ndërsa tjetrët do të refuzohen automatikisht. Për më shumë informacion ju lutemi të qaseni në linkun e mëposhtëm: <https://erasmus-plus.ec.europa.eu/opportunities/organisations/cooperation-among-organisations-and-institutions/capacity-building-vet>

**Ngritja e kapaciteteve
në fushën e
ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL**

ERASMUS+

- ec.europa.eu/erasmus-plus
eacea.ec.europa.eu
 facebook.com/EUErasmusPlusProgramme
 [EU_Erasmus_Plus](https://twitter.com/EU_Erasmus_Plus)

Kosovo Erasmus+ Office

- office@erasmuspluskosovo.org
 www.erasmuspluskosovo.org
 facebook.com/erasmuspluskosovo
 <https://www.linkedin.com/company/kosovo-erasmus-office/>



Mbështetur nga:  EUROPE HOUSE



**Ngritja e kapaciteteve
në fushën e
ARSIMIT DHE
FORMIMIT PROFESIONAL**

 Erasmus+
Enriching lives, opening minds.

 Erasmus+
Enriching lives, opening minds.



Projektet e ngritjes së kapaciteteve janë projekte bashkëpunimi ndërkombëtar të bazuara në partneritete shumëpalëshe ndërmjet organizatave aktive në fushën e AFP-së në Shtetet Anëtare të BE-së dhe vendet e treta të lidhura me Programin, dhe vendet e treta që nuk janë të lidhura me Programin.



Ato synojnë të mbështesin rëndësinë, aksesueshmërinë dhe reagimin e institucioneve dhe sistemeve të AFP-së në vendet e treta që nuk janë të lidhura me Programin si një nxitës i zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik.



Fushat tematike

Veçoritë që karakterizojnë ndërtimin e kapaciteteve në AFP përfshijnë disa fusha tematike të paraqitura më poshtë. Propozimet duhet të fokusohen në një ose më shumë nga temat e mëposhtme:

- Mësimi i bazuar në punë (për të rindjtë dhe/ose të rriturit);
- Mekanizmat e sigurimit të cilësisë;
- Zhvillimi profesional i mësuesve/trajnuesve të AFP-së;
- Kompetencat kyçe, duke përfshirë sipërmarrjen;
- Përputhja e aftësive në sektorët ekonomikë që shikojnë nga e ardhmjë;
- Mbështetje për zhvillimin e aftësive të gjelbra dhe dixhitale për tranzicionin binjak.

Përveç kësaj, aplikanti mund të mbulojë fusha tematike që nuk janë paraqitur më sipër. Këto duhet të tregojnë se janë veçanërisht të përshtatshme për të përbushur objektivat e thirrjes dhe nevojat e identikuara.

Kush mund të aplikoj?

Çdo organizatë publike dhe private aktive në fushën e AFP-së dhe e themeluar ligjërisht në një Shtet Anëtar të BE-së ose në një vend të tretë të kualifikuar të lidhur me Programin. Aplikanti duhet të aplikoj në emër të të gjitha organizatave pjesëmarrëse të përfshira në projekt.

Cilat lloje të organizatave kanë të drejtë të marrin pjesë në projekt?

Organizatat pjesëmarrëse të pranueshme:

- Ofruesit e arsimit dhe formimit profesional themeluar ligjërisht në një Shtet Anëtar të BE-së



ose në një vend të tretë të kualifikuar të lidhur me Programin ose në një vend të tretë të kualifikuar që nuk është i lidhur me Programin;

- Organizata të tjera publike ose private aktive në fushën e AFP-së dhe në tregun e punës dhe të themeluara ligjërisht në një Shtet Anëtar të BE-së ose në një vend të tretë të kualifikuar të lidhur me Programin ose në një vend të tretë të kualifikuar që nuk është i lidhur me Programin;

- Partnerët e asociuar nga sektori publik ose privat që kontribuojnë në zbatimin e detyrave/aktivitetave specifike të projektit ose mbështesin shpërndarjen dhe qëndrueshmërinë e projektit. Për çështjet e menaxhimit kontraktual, partnerët e asociuar nuk konsiderohen si pjesë e partnerëve të projektit dhe nuk marrin fonde.